

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikasil® AC

IZOLUES SILIKONI PËR APLIKIME TË PËRGJITHSHME



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikasil® AC është izolues për fugat, acetoksid, me 1 përbërës, nuk varet dhe ofron një izolim elastik të papërshkueshëm nga uji.

PËRDORIMET

- Hidroizolim i llojeve të ndryshme të fugave të ndërtimit
- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Modul i ulët elasticiteti
- Elasticitet i lartë
- Aplikim pa prajmer mbi shumë nënshtresa

- Ngjitje e mirë mbi shumë lloje nënshtresash
- Rezistencë e mirë ndaj ekspozimit UV
- Pa tretës (sipas TRGS 610)

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Deklarata IBU e produktit për mjedisin (EPD)

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-1 - Izolues për përdorim jostrukturor në fugat e ndërtesave - Elemente fasdash
- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-2 - Izolues për përdorim jostrukturor në fugat e ndërtesave - Izolues për xhamat

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Silikon acetoksid
Ambalazhi	tubetë 300 ml: 12 copë/ kuti
Ngjyra	Transparent, i bardhë
Jetëgjatësia	18 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në amblazhin origjinal të vulosur, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +25 °C. Lexoni gjithmonë ambalazhin.
Dendësia	~1,00 kg/l (ISO 1183-1)
Deklarata e produktit	EN 15651-1: F EXT-INT CC EN 15651-2: G CC

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~20 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~1,8 N/mm ²	(ISO 8339)

Fleta e të dhënave të produktit

Sikasil® AC

Dhjetor 2019, Botimi 03.01

02051403000000079

Moduli i shformimit elastik	~0,35 N/mm ² në 100 % zgjatim	(ISO 8339)
Zgjatimi deri në thyerje	~550 %	(ISO 37)
Risjellja elastike	> 90 %	(ISO 7389)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~2,6 N/mm	(ISO 34)
Aftësia për lëvizje	±20 %	(ISO 9047)
Temperatura e funksionimit	-40 °C / +100 °C	
Projektimi i fugës	Përmasat e fugës duhet të projektohen për t' u përshtatur me aftësinë e izoluesit për lëvizje. Për fuga me gjerësi ≥ 10 mm dhe ≤ 20 mm, rekomandohet thellësi fuge prej 10 mm. Për fuga më të gjera kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione shtesë.	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Gjerësi fuge [mm]	Thellësi fuge [mm]	Gjatësi fuge [m] për 300 ml
	10	10	3,0
	15	10	2,0
	20	10	1,5

Konsumimi varet nga ashpërsia dhe absorbueshmëria e nënshtresës. Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Rrjedha e varjes	< 1 mm (profil 20 mm, +23 °C)	(ISO 7390)
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max., min. +3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Ritmi i maturimit	~3 mm/24 orë (+23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP* 049-2) * Sika Corporate Quality Procedure
Koha e krijimit të kores	~25 min (+23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 019-1)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislleqet, vaji, graso, kore çimentoje (qumësht), izolues të vjetër dhe veshje boje me ngjijtje të dobët, të cilat mund të ndikojnë mbi ngjijtjen e izoluesit. Nënshtresa duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme për t' u rezistuar sforcimeve të ushtruara nga izoluesi gjatë lëvizjes. Mund të përdoren teknika pastrimi si fërkimi me furçë teli, bluarje, pastrim me rrymë rëre ose mjete të tjera mekanike. Pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të aktivizuesit, prajmerit ose izoluesit. Sikasil® AC ngjitet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Për ngjijtje të shkëlqyer, qëndrueshmëri fuge dhe aplikime kritike me performancë të lartë si ndërtesat shumëkatëshe, fugat me sforcim të lartë, ekspozimi në kushte ekstreme moti dhe / ose ujë, duhet të ndiqen

procedurat e mëposhtme të lyerjes me prajmer dhe/ose trajtimit paraprak:

Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, PVC, çeliku i galvanizuar, metalet e veshura me bojë në formë pluhuri ose pllakat me glazurë. Ashpëroni lehtësisht sipërfaqen me një letër smerile. Pastroni dhe trajtoni paraprakisht me Sika® Aktivator-205 të aplikuar mbi një copë të pastër.

Përpara izolimit, lini kohë pritjeje > 15 minuta (< 6 orë).

Metalet e tjera si bakri, bronzi dhe titanium-zink, duhet të pastrohen dhe trajtohen paraprakisht me Sika® Aktivator-205 të aplikuar mbi një copë të pastër. Lini kohë pritjeje > 15 minuta (< 6 orë). Aplikoni Sika® Primer-3 N me furçë. Përpara izolimit lini kohë pritjeje > 30 minuta (< 8 orë)

PVC duhet të pastrohet dhe të trajtohet paraprakisht me Sika® Primer-215 të aplikuar me furçë. Përpara izolimit, lini kohë pritjeje > 30 minuta (< 8 orë). Qelqi duhet të pastrohet me Isopropanol përpara aplikimit.

Nënshtresa poroze

Nënshtresat poroze duhet të lyhen me prajmerin Sika® Primer-3 N të aplikuar me furçë. Për më shumë detaje aplikimi apo kohët e tharjes, lexoni skedën teknike më të fundit të produktit përkatës të trajtimit paraprak. Përpara izolimit, lini kohë pritjeje > 30 minuta (< 8 orë).

Duhet të kryhen testime ndërkapjeje mbi nënshtresat specifike të projektit dhe proceduar të pranohen nga të gjitha palët përpara aplikimit të plotë të projektit. Për më shumë këshilla dhe udhëzime të detajuara kontaktoni shërbimin teknik Sika.

Shënim: Prajmerat dhe aktivizuesit janë përforcues të ndërkapjes dhe jo një alternativë për përmirësimin e përgatitjes / pastrimit të dobët të sipërfaqes së fugës. Prajmerat përmirësojnë gjithashtu performancën afatgjatë të ngjitjes së fugës së izoluar.

PËRZIERJA

1 përbërës gati për përdorim

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ndiqni me kujdes procedurat e instalimit siç përcaktohet në Method Statement, manualët e aplikimit dhe udhëzimet e punimeve të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier.

Maskimi

Rekomandohet përdorimi i shiriti maskues aty ku kërkohen vija të sakta dhe të drejta fugash. Pasi të keni mbaruar, hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores.

Mbushja e fugës

Pas përgatitjes së kërkuar të nënshtresës, vendosni kordonin mbushës në thellësinë e kërkuar.

Lyerja me prajmer

Nëse kërkohet, lyeni me prajmer sipërfaqet e fugave si rekomandohet për përgatitjen e nënshtresës. Shmangni aplikimin me tepri të prajmerit, për të mos krijuar pellgje në bazën e fugës.

Aplikimi

Sikasil® AC është gati për përdorim. Përgatisni fundin e tubetës, vendoseni tek pistoletat dhe mbërtheni majën. Nxirrni Sikasil® AC brenda fugës duke u siguruar se është në kontakt të plotë me anët e fugës dhe se nuk ka bllokim ajri.

Finirimi

Sapo të jetë e mundur pas aplikimit, izoluesi duhet të ngjeshet mirë në anët e fugës për të siguruar një ngjitje të mirë dhe sipërfaqe të lëmuar. Përdorni një agjent kompatibël për nivelimin e sipërfaqes së fugës. Mund të përdoret ujë. Mos përdorni produkte përpunimi me përmbajtje tretësi.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Remover-208 menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht. Për pastrimin e lëkurës, përdorni Sika® Cleaning Wipes-100.

DOKUMENTA SHITESË

Fleta e të dhënave të produktit

Sikasil® AC

Dhjeter 2019, Botimi 03.01

02051403000000079

- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin & ngjitjen

KUFIZIME

- Të mos përdoret mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM apo mbi çdo material ndërtimi prej të cilit mund të rrjedhin vajra, plastifikues ose tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.
- Të mos përdoret në zona plotësisht të mbyllura, pasi kërkohet lagështi atmosferike për t' u tharë.
- Sikasil® AC nuk rekomandohet për nënshtresa poroze, si betoni, guri, mermeri dhe graniti. Mund të ketë njolllosje nga migrimi i plastifikuesit kur përdoret mbi këto nënshtresa. Duhet të kryhen testime paraprake për të kontrolluar nëse nënshtresa njolloset përpara aplikimit të plotë të produktit.
- Të mos përdoret aty ku ka mundësi të ndodhë ekspozim fizik apo abrazion, xhama strukturorë apo xhama me izolim dhe aplikime në kontakt me ushqimet. Kontaktoni shërbimin teknik Sika për këshilla rreth produkteve alternative.
- Të mos përdoret për përdorime mjekësore apo farmaceutike.
- Acidi acetik i çliruar gjatë tharjes mund të shkaktojë korrodimin e argjendit të pasqyrave dhe metaleve të ndjeshme si bakri, bronzi dhe plumbi.
- Të mos përdoret mbi sipërfaqe alkaline si betoni, suvaja and tullat.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdo afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdo formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikasil® AC
Dhjetor 2019, Botimi 03.01
02051403000000079

SikasilAC-sq-AL-(12-2019)-3-1.pdf

